

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për krime të rënda – kryetari i trupit gjykues Vehbi Kashtanjeva, Kryetar i trupit gjykues dhe anëtarëve të trupit gjykues – gjyqtarëve, Alltëne Murseli dhe Isuf Makolli, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Ferinaze Jashari, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.H., mbrojtësit të tij B.T., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë së Qarkut tani Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PP.nr.490-3/2009, të datës 19.08.2009, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar verbal e publik në prezencë të prokurorit Armend Hamiti, me datë 24.09.2018, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I

I akuzuari :

A.H., nga i ati Q., dhe nëna S., e gjinisë K., i lindur më dt...., në fshatin P.1-P.2, me vendbanim në lagjen E. rr. R.K., pn P.2, ka të kryer shkollën e mesme Ekonomike, ekonomistë, i martuar, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ESHTË FAJTOR

SEPSE:

Me dt.29.05.2009, rreth ores 18:45, në rr. ‘‘E.M.’’ në P., në brendësinë e restorantit A., për shkak të mosmarrëveshjes në mes dy kompanive të sigurimit B.1 ‘‘S.’’, me pronarin e të pandehurit A.H. me 7-8 punëtorë të kësaj kompanie si dhe nga ana tjetër kompania e sigurimit ‘‘D. S.’’, me pronar B.L. me 3-4 punëtorë të kësaj kompanie, pas nje fjalosje që e kishte rreth shtrirjes së biznesit të tyre, pasi punëtorët e sigurimit ‘‘D.’’ ditë më pare hjekin pajisjet-transmetorët e kompanisë së sigurimit ‘‘B.1’’, në shtëpinë e të dëmtuarit T.H., ka ardhur deri te eskalimi i situates, ashtu që I pandehuri A. ka nxjerrë armen e tipi tCrvena Zastava 99 compact-G me numër serik 13875, të cilën e ka bartur me vete pa leje, e me të vërejtur i pandehuri B.2, merr shishen nga tavolina dhe e godet dy her në kokë të pandehurin A., duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, gjersa të pandehurit e tjerë që ishin present fillojn të rrahen ndërmjet veti me karriga, shufra metalike, fillojn të gjuhen dhe ta godasin njëri tjetrin, ashtu që i pandehuri A. me qëllim që ti privoi nga jeta të pandehurin B.2 shtënë dy here me revole, ku njëri plumb përshkon këmbën e tij të majt, gjersa ishin të mbështjellur njëri me tjetrin për trupi arrin I pandehuri A.2 dhe duke tentuar të ja tërhjek revolen nga dora të pandehurit A.1, me revolën që e mbante në dorë shtën në drejtim të të pandehurit A.2 tri here me çrast e godet fillimisht kemben e djatht deperton predha duke kaluar në këmbën e majt dhe del jasht, gjegjësisht një plumb ja përshkon këmbët, dhe I shkakton lëndime të rënda trupore,

-me këtë ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së,

Andaj gjykata në kuptim të neneve 2,3,4,41,42,49,50,51,69,73,74,75,76 të KPRK-së dhe nenit 359, 365, 450 të KPPRK-së e :

GJYKON

ME DËNIM ME BURGIM - DËNIM ME KUSHT në kohëzgjatje prej **2 (dy) vite**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afat prej **3 (tri) viteve** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt:29.05.2009 deri me dt:24.07.2009.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogaris përfundimtare të Gjykatës dhenë emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **100 (njëqind) euro**, në afat prej **15 ditësh** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhetë paguaj shumën prej nga **50 (pesëdhjetë) euro**, në emër taksën për kompensimin e viktimave në baze të nenit 39 Ligji nr. 05/L për kompensimin e viktimave të krimit.

Të akuzuarit i konfiskohet arma CrvenaZastava 99 compact-G me numër serik 13875,

A r s y e t i m

Ish Prokuroria e Qarkut tani Themelore Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë PP.nr.490-3/2009, të datës 19.08.2009, kesaj gjykate i ka paraqitur Marrëveshjen për pranimin e fajësisë për të akuzuarin A.H., për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së,

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë me dt. 24.09.2018, në të cilin shqyrtim:

I akuzuari A.H.ka deklaruar se me dt. 17.09.2018, në Prokurorin e Shtetit kemi arritë Marrëveshje për pranimin e fajësisë, kektëmarrëveshje e kam arrite pa kurrfarë presioni, ku ka qenë prezent edhe mbrojtësi im av. B.T., duke i ditur të gjitha pasojat dhe benifidet me rastin e nënshkrimit për pranimin e fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. B. T.2, se në paraprakisht kemi lidhur Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe për të gjitha pasojat dhe benifidet që rrjedhin nga kjo marrëveshje për pranimin e fajësisë me kohë është njoftuar tani i akuzuari A.H. dhe i njëjti e ka dhënë pëlqimin që kjo marrëveshje të arrihet të nënshkruhet, në dt: 17.09.2018 dhe është nënshkruar nga Kryeprokurori Ymer Beka dhe Prokurori i Shtetit Armend Hamiti,

Prokurori i Shtetit Armend Hamiti deklaroi : në lidhje me aktakuzën e ushtruar kundër A.H.për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së, paraprakisht me të pandehurin në prezencën e mbrojtësit të tij kemi arritur Marrëveshjen për pranimin e fajësisë me qastpala është njoftuar me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e kësaj Marrëveshje dhe konsultim të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij është arritur kjo Marrëveshje dhe i propozoj Gjykatës që të akuzuarit ti shqiptoi një dënim në kohëzgjatje prej 2 viteve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk brenda afatit prej 3 viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk do të kryen ndonjë vepër tjetër penale, pasi që prokuroria ka pasur në konsideratë rrethanat lehtësuese se i akuzuari ka qenë i provokuar nga i akuzuari B.L. i njëjti ka

pranuar fajësinë edhe kjo të merret si rrethanë lehtësuese, ka shprehur keqardhje, po ashtu ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe koha e qëndrimit në arrest shtëpiak.

Gjykata e ka pranuar Marrëveshjen për pranimin e fajësise të lidhur ne dt: 17.09.2018 në mes të Keyeprokurorit Ymer Beka, Prokurorit të shtetit Armend Hamitit mbrojtësit të akuzuarit av. B.T. si dhe të akuzuarit A.H., pasiqe jane plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 233, par. 18, te KPPK-së, gjate shqyrtimit gjyqësorë është ndëgjuar, mbrojtësi I të akuzuarit dhe prokurori i shtetit dhe pas degjimit te tij ka ardhur deri te konstatimi se i akuzuari e ka kuptuar natyren dhe pasojat e marrëveshjes për pranimin e fajësise, pranimi i fajësise është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve me mbrojtësin e tij dhe i akuzuari nuk kaqenë i detyruar ne asnje menyre ta pranoj fajësine dhe pranimi i fajësise është mbeshtetur ne fakte dhe prova materiale te rasitit konkret te cilat paraqiten ne aktakuzë dhe nuk ka ekzistuar asnje rrethane e parapare me nenin 253, te KPPK-së.

Me rastin e përcaktimit të denimit gjykata pati parasysh të gjitha rreth anat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit mori parasysh si rrethane lehtësuese se i akuzuari ka qenë i provokuar nga i akuzuari B. L. i njëjti e ka pranuar fajësinë edhe kjo të merret si rrethanë lehtësuese, ka shprehur keqardhje pranimin e fajësisë dhe pendimin e tij të thellë, sinqeritetin e tij deklarues, si dhe për të akuzuarin në evidence e gjykatës nuk ka ndonjë të dhënë se I njëjti ka kryer ndonjë veprë tjetër penale. Për të akuzuarin gjykata nuk gjeti rrethana rënduese.

Gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe me aplikimin e dispozitave ligjore të përmendura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe i njëjti do të shërbejë si preventive individuale, gjenerale dhe parandalim se në të ardhmen nuk do të kryej veper tjetër penale, duke ndikuar në rehabilitimin e tij.

Ngasa u thamë lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
P.nr.387/09, të dates 24.09.2009**

Procesmbajtësja:

Ferinaze Jashari

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari:

Vehbi Kashtanjeva

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.